



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “N&B shpk” të datës 07.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “N&B shpk” të datës 07.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “N&B shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 07.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: *“Qe do të thote ne si GOE me cmim me te ulët dhe vetem per nje nenshkrim ne CV-në e njerit nga Punonjesit e stafit teknik ne kete rast Z. Lavdim Babaj na kemi leminuar direkt pa kerkuar as edhe nje sqarim shites”. Parashtruesi ka prezantuar po ashtu edhe pretendimet ndaj tenderuesit të rekomanduar por edhe ofertuesve të tjerë.*

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Ju si GOE-ik nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për piken e kërkesës nr.1. Kërkesa: 7. Minimum dy (2) saldues të certifikuar sipas standardit ISO EN ISO 9606: Dëshmia e kërkuar dokumentare: 7. •Certifikatat; •Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; •Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; Ju si GOE-ik për këtë pike te kërkesës me ofertën tuaj keni prezantuar 2 saldues; Për Salduesin z. Lavdim Babaj keni dorëzuar dokumentacionin: Certifikatën EN ISO 9606, Kontratën për punë (para kontratën) si dhe Biografinë CV-në - CV e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, andaj sipas UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËRPROKURIMIN PUBLIK / CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat/ Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ Neni 69. Ju si GOE-ik keni prezantuar – dorëzuar CV-në e pa nënshkruar nga kandidati z. Lavdim Babaj. Andaj dhe për arsyeje të cekura me lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parimisht nuk i konteston fare arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme por vetëm thekson që është dashur AK të kërkoj sqarime shitesë. Në rastin konkret nuk ka aspak hapësirë për të kërkuar sqarime shitesë AK në kuptim të nenit 72 të LPP për arsye se sipas pikës 10 të UPP përcaktohet që në rastet kur CV nuk i përmbush kërkesat e DT – tenderi refuzohet pa kërkuar sqarime shitesë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesit e tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e papabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.07.2025



Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.